

FJALA E DEPUTETES ILDA DHORI

E HËNË 31 TETOR 2022

Përshëndetje!

E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë të Republikës së Shqipërisë,

Personalisht, në fillim të nismës për të bërë një reformë territoriale për shqiptarët isha skeptike, sepse për të bërë një reformë të mirë territoriale në shërbim të qytetarëve, së pari, duhet të ketë vullnet nga të dyja palët. Opozita, që në fillim të kësaj nisme, e ka pasur një nga prioritetet kryesore të saj reformën territoriale, bazuar në kërkesat e vetë qytetarëve, por nuk pashë asnjë lloj angazhimi nga maxhoranca për të rishikuar ndarjen territoriale të Republikës së Shqipërisë. Në vitin 2014 partia në pushtet vendosi arbitrarisht, në mënyrë të njëanshme, të ndërhyjë në hartën territoriale dhe të eksperimentojë në shërbimin ndaj shqiptarëve për synimet e veta të qarta politike.

Sot, pas 7 vjetësh nga riorganizimi i hartës administrativo-territoriale të Republikës së Shqipërisë, mund të themi se ishte një eksperiment i dështuar për shqiptarët, sepse sot Shqipëria është shpopulluar dhe shqiptarët po largohen dita-ditës, por ishte një eksperiment i suksesshëm për partinë në pushtet falë strategjisë së mirëmenduar shpopulluese dhe shtypëse ndaj qytetarëve. Sot është i qartë dështimi i reformës territoriale të vitit 2014, e cila nuk i ka arritur objektivat për të cilat u iniciua. Sot qeverisja lokale është bërë më e dobët; shërbimet ndaj qytetarëve nuk janë rritur në cilësi; pavarësia ekonomike e bashkive është e kufizuar dhe sistemi i vetëqeverisjes lokale nuk është arritur.

Një nga objektivat fillestare të reformës ishte ulja e numrit të administratës dhe të shpenzimeve për të. Sot, përkundrazi, rezulton që numri dhe shpenzimet e administratës janë rritur. Objektiv tjetër i vendosur në vitin 2014 dhe i dështuar, gjithashtu, ishte rritja e cilësisë së shërbimit ndaj qytetarit. Sot, me zgjerimin territorial të bashkive, qytetarët marrin më pak shërbim, sepse u duhet të përshkojnë kilometra të tëra për një dokument, më shumë radhë dhe më shumë kohë fizike. Njësitë administrative të bashkive sot janë kthyer në institucione formale, fantazmë, pa asnjë lloj funksioni administrativ në raport me qytetarët, ndryshe nga komunat dikur, të cilat, në fakt, sillnin shërbimin aty ku ishte kërkesa

për të. Legjislacioni i ri, me ndikim në qeverisjen vendore, nuk është harmonizuar ende dhe nuk është zbatuar plotësisht, ndërsa bashkive u është dhënë fuqi më e madhe.

Nga ana tjetër, mjaftueshmëria e burimeve financiare dhe autonomia fiskale e njësive të qeverisjes vendore janë të kufizuara dhe mbi 70% e buxhetit të bashkive vjen nga buxheti i shtetit. Nga auditimi i KLSH-së në vitin 2018 për ndarjen administrativo-territoriale u konstatua se: bashkitë, përveç Bashkisë së Tiranës, mbledhin më pak të ardhura dhe ofrojnë më pak shërbim për qytetarët. Sipas KLSH-së, me decentralizimin fiskal nuk është arritur rritja e buxhetit të bashkive dhe performanca e tyre ka mbetur e ulët. Bazuar në sa më sipër, KLSH-ja rekomandon rishikimin dhe riorganizimin e hartës territoriale të Republikës së Shqipërisë.

Partia Demokratike e mbështet riorganizimin e kësaj harte për më shumë shërbime dhe aksesueshmëri ndaj qytetarëve. Shtimi i numrit të bashkive është domosdoshmëri. Një reformë territoriale, e arsyeshme, e mirëkonsultuar dhe e përmirësuar duhet të lërë jashtë saj interesat e ngushta partiake dhe të projektohet kryesisht në realitetin që prek çdo shqiptar. Faleminderit!